



Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosovo Association of the Blind
Udruzenje slepih Kosova

Thirrje për aplikim

Mundësi për punësim

**Projekti: RRitja e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë
Mbështetur nga komisioni evropian dhe implementuar nga People in Need (PIN) në partneritet me
HandiKos dhe Shoqatën e të Verbërve të Kosovës (SHVK)**

People in Need (PIN) – një organizatë jo-qeveritare me seli në Republikën Çeke, e përkushtuar për zhvillim dhe bashkëpunim, shpërndarjen e ndihmave humanitare në zonat në nevojë, dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me traditë të gjatë të punës në Ballkanin Perëndimor. Aktivitetet aktuale në Kosovë përfshijnë ndihmën për njerëzit me aftësi të kufizuara në forma të ndryshme, si dhe mbështetje për arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët nga komunitetet më të marginalizuara. Për më shumë informacion ju lutem shikoni www.peopleinneed.cz.

Në këtë periudhë, PIN me mbështetjen e Komisionit Evropian dhe në partneritet me dy organizatat lokale Handikos dhe SHVK, po zbaton një projekt 24 - mujor me qëllimin e përgjithshëm për të kontribuar në tranzicionin e grupeve më të marginalizuara në tregun e punës nga asistenca sociale dhe varësisë ekonomike drejt mundësive për punësim dhe vetëpunësim në komunat: Prishtinë/Priştina, Prizren and Ferizaj/Uroševac.

Në kuadër të këtij programi, PIN, HandiKos dhe SHVK, janë në kërkim të një kandidati për Këshilltar për Punësim në komunën e Prizrenit. Këshilltari për punësim do të marrë rolin e ofruesit të mbështetjes direkte për personat me aftësi të kufizuara - PAK në përgatitjen për tregun e punës dhe punësim ose vetë-punësim.

Nëse do përzgjidheni, atëherë përgjegjësitë e juaja do jenë si më poshtë:

- Ndihmë për të gjetur punë të përshtatshme për njerëzit me aftësi të kufizuara
- Këshillim,
- Kërkim për punëdhënës të përshtatshëm, duke punuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin dhe përfituesit
- Ndihmë për përdoruesit gjatë trajnimit në vendin e punës
- Koordinimin dhe menaxhimin e vullnetarëve / asistentëve
- Mbajtja dhe regjistrimi i të dhënave
- Përgatitja dhe raportimi te Udhëheqësi i Ekipit dhe Menaxheri i Projektit



An EU funded project managed by the
European Union Office in Kosovo



Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosovo Association of the Blind
Udruzenje slepih Kosova

Ne do të jemi të lumtur për t'u takuar me ju për një intervistë, në qoftë se ju i përmbushni kërkesat e mëposhtme:

- Përvojë në ofrimin shërbimeve sociale dhe të burimeve njerëzore
- Aftësi të mira komunikimi dhe organizative
- Aftësi për të punuar në grup
- Kreativitet
- Njohuri të mira të internetit dhe mjeteve themelore të përpunimit të dokumenteve
- Shkolla e mesme e lartë në fushën përkatëse

Nëse jeni i/e interesuar, ju lutem dërgoni CV tuaj dhe një letër të shkurtër motivimi në e-mail adresën: rinor.gashi@handi-kos.org.

Afati i fundit për aplikim është 20 Maj 2016.



An EU funded project managed by the
European Union Office in Kosovo